

KRYETARI



Nr. _____ prot.

Kavajë, më __, __, 2025

Lënda: Dërgohet material për shqyrtim e miratim

Z. Rudin Hylviu

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIA KAVAJË

I nderuar zoti Kryetar,

Bashkëngjitur po ju dërgojmë projekt vendimin, dhe relacionin shoqërues,:

“ PËR MIRATIMIN E SHPRONSIMIT PËR INTERES PUBLIK TË PASURISË PRONË PRIVATE QË PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “RIKONSTRUKSIONI I TROTUARËVE LAGJIA SHEH ”

Me respekt,

KRYETARI

Fisnik Qosja

Miratoi:



Arti Çiçolli : Sekretari i Përgjithshëm

Datë: _____

Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: 1 (një)

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: 1 (një)

Nr. i fletëve të dokumenteve që shoqërojnë projekt vendimin: 13 (trembëdhjete)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË

PROJEKT-V E N D I M

Datë ____ / ____ / 2025

“ PËR MIRATIMIN E SHPRONSIMIT PËR INTERES PUBLIK TË PASURISË PRONË PRIVATE QË PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “RIKONSTRUKSIONI I TROTUARËVE LAGJIA SHEH ”

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 9 pika 1.2, germa “b” Ligjit Nr. 8561, datë 22.12.1999 i ndryshuar, VKM nr.138 datë 23.03.2000 “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik” i ndryshuar VKM nr.89 date 03.02.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, dhe vleresimin parapra për këto pasuri. Shkresa me Nr.3845/1 prot datë 26.10.2023 të ASHK Drejtoria Vendore Kavajë si dhe vendimin e Keshillit Bashkiak nr.68 datë 23.12.2024 “Për miratimin programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 dhe buxheti 2025” vendimin e Këshillit Kombëtar të territorit me nr.2 datë 27.04.2018 per PPV për Kavajën, vleresimi paraprak i pasurisë pronë private ku shtrihet investimi dhe gjurma e projektit është bazuar në gjendjes juridike të pasurisë, të konfirmuara nga Agjensia Shtetërore e Kadastrës Drejtoria Vendore Kavajë, me propozim të kryetarit të Bashkisë Kavajë, Këshillit Bashkiak i propozohet:

TË VENDOSË

1. Nisjen e procedurave ligjore të shpronësimit për interes publik, për realizimin e projektit **“RIKONSTRUKSIONI I TROTUARËVE LAGJIA SHEH ”** për pasurinë e paluajtëshme të llojit truall, në zonën kadastrale 8552 Kavajë, që preket nga realizimi i këtij projekti.
2. Nga realizimi i projektit **“RIKONSTRUKSIONI I TROTUARËVE LAGJIA SHEH”** preket një pjesë e pasurisë nr. 8/148 vol. 10 faqe 148 e llojit “truall” ndodhur në ZK 8552 Kavajë e regjistruar në emër të bashkëpronarëve Shehu sipas listës.
3. Totali i sipërfaqës që do të shpronësohet për interes publik është 58.4 m²
4. Vlera paraprake e shpronësimit për interes publik është në shumën 452308 (*katër qind e pesë dhjetë e dy mijë e tre qind e tetë*) lekë e cila do të përballohet nga buxheti i Bashkisë Kavajë.
5. Për vazhdimin e mëtejshëm të procedurave të shpronësimit deri në daljen e VKM-së për shpronësim për interes publik ngarkohen Drejtoria e Kadastrës Urbane dhe Menaxhimit të Aseteve Publike, Drejtoria Juridike, Drejtoria e Burimeve Ekonomike, Drejtoria e Planifikimit Zhvillimit të territorit dhe Menaxhimit të Kontratave.
6. Ky Vendim hynë në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, neni 55, të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, pas konfirmimit nga institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

Sekretari i përgjithshëm
Arti Çicolli

Drejtoria e Planifikimit Zhvillimit të territorit dhe Menaxhimit të Kontratave
Dëshira Qato

Drejtoria Ligjore
Adrian Malaj

Drejtoria e Burimeve Ekonomike
Andi Çurgu

Sekretare e Keshillit Bashkiak
Meri Biturku

KRYETARI I BASHKISË
FISNIK QOSJA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË

Nr. 2980/2 Prot.



Kavajë, më 16 . 07 2025

VLERËSIMI PARAPRAK

Në zbatim të Ligjit nr. 8561 datë 22.12.1999 “ Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik ” i ndryshuar, është ngritur Urdhëri nr. 274 datë 27.06.2024 “Për ngritjen e Komisionit për kryerjen e procedurave paraprake për shpronësimin e pasurive në pronësi private, për interes publik, në zbatim të projekteve të miratuara nga Bashkia Kavajë” i ndryshuar me urdhërin nr. 155 datë 09.06.2025 i përbërë nga anëtarët; Eni Xoxe-kryetarë komisioni, Kris Biturku-anëtarë komisioni, Kevin Çaçanëtarë komisioni, Bekim Shala-anëtarë komisioni, Erdi Berati-anëtarë komisioni.

Në kuadër të përmirësimit të infrastrukturës publike dhe rritjes së sigurisë për këmbësorët në zonat e banuara, Bashkia Kavajë ka planifikuar realizimin e projektit “**Rikonstruksioni i Trotuareve – Lagja Sheh**”, që synon sistemimin, zgjerimin dhe rehabilitimin e trotuareve ekzistuese në këtë lagje.

Gjatë hartimit dhe miratimit të projektit është konstatuar se një pjesë e pasurisë private me të dhënat si më poshtë, preket nga ndërhyrja fizike për realizimin e projektit:

- Zona Kadastrale: 8552
- Numri i Pasurisë: 8/148
- Sipërfaqja që do të shpronësohet: 58.4 (*pesëdhjetë e tetë pikë katër*) m²
- Lloji i pasurisë: truall
- Pronari: bashkëpronarët Shehi (sipas listës së bashkëpronarëve)

Kjo sipërfaqe është e domosdoshme për realizimin e projektit dhe përmbushjen e qëllimit publik, duke siguruar kalueshmëri të sigurt për qytetarët dhe funksionalitet të plotë të infrastrukturës së trotuareve.

Mbështetur në VKM-në nr.89 date 03.02.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, cmimi i referencës për m² të pasurisë së llojit arë në këtë zonë kadastrale është 7745 lekë për m².

Për sa më sipër, vlera paraprake e përlllogaritur nga Komisioni i Shpronësimit është;

58.4 m2 x 7745 lekë për m2 = 452308 (katër qind e pesë dhjete e dy mijë e tre qind e tete) lekë

Vlera paraprake e përllogaritur nga Komisioni i Shpronësimit në Bashkinë Kavajë është sipas tabelës së mëposhtme.



Pasuria e paluajtshme qe preket nga projekti Rikonstruksioni i Trotuareve – Lagja Sheh” për Bashkinë Kavajë është :

Nr	Pasuria	lloji i pasurisë	Sip. Shprons. M ²	ZK	Vol	Faqe	Çmimi njesi/ leke m2	Vlera ne leke	Adresa e pronarëve që preken nga shpronsimet	Kufizimet e pronësisë
1	8/148	truall	58.4	8552	10	148	7745	452308	Kavaje	-

Komisioni i Vleresimit paraprak të shpronësimit:

Eni Xoxe

Kevin Çaç

Kris Biturku

Bekim Shala

Erdi Berati

RELACION

“ PËR MIRATIMIN E SHPRONSIMIT PËR INTERES PUBLIK TË PASURISË PRONË PRIVATE QË PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “RIKONSTRUKSIONI I TROTUARËVE LAGJIA SHEH”

Në kuadër të përmirësimit të infrastrukturës publike dhe rritjes së sigurisë për këmbësorët në zonat e banuara, Bashkia Kavajë ka planifikuar realizimin e projektit **“Rikonstruksioni i Trotuareve – Lagja Sheh”**, që synon sistemimin, zgjerimin dhe rehabilitimin e trotuareve ekzistuese në këtë lagje.

Gjatë hartimit dhe miratimit të projektit është konstatuar se një pjesë e pasurisë private me të dhënat si më poshtë, preket nga ndërhyrja fizike për realizimin e projektit:

- Zona Kadastrale: 8552
- Numri i Pasurisë: 8/148
- Sipërfaqja që do të shpronësohet: 58.4 (pesëdhjetë e tetë pikë katër) m²
- Lloji i pasurisë: truall
- Pronari: bashkëpronarët Shehi (sipas listës së bashkëpronarëve)

Kjo sipërfaqe është e domosdoshme për realizimin e projektit dhe përmbushjen e qëllimit publik, duke siguruar kalueshmëri të sigurt për qytetarët dhe funksionalitet të plotë të infrastrukturës së trotuareve.

Vlerësimi paraprake i përllogaritur nga Komisioni i Shpronësimit në Bashkinë Kavajë i ngritur me Urdhërin nr. 274 datë 27.06.2024 “Për ngritjen e Komisionit për kryerjen e procedurave paraprake për shpronësimin e pasurive në pronësi private, për interes publik, në zbatim të projekteve të miratuara nga Bashkia Kavajë” i ndryshuar me urdhërin nr. 155 datë 09.06.2025, i është referuar VKM-së nr.89 date 03.02.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë sipas të cilës cmimi për tokën truall në zonën kadastrale 8552 është 7745 lekë/m².

Nga realizimi i këtij projekti, gjurma që bie mbi pasurinë pronë private me nr. 8/148 Z.K. 8552, prek 58.4m². Për sa më sipër vlera paraprake e përllogaritur nga komisioni është në vlerën 452308 (katër qind e pesë dhjetë e dy mijë e tre qind e tete) leke, vlerë e cila do të përballohet nga buxheti i Bashkisë Kavajë.


Pasuria e paluajtshme që preket nga projekti “RIKONSTRUKSIONI I TROTUARËVE LAGJIA SHEH ” për Bashkinë Kavajë është :

Nr	Pasuria	Iloji pas.	Sip. Shpron s. M ²	Z.K	Vol	Fq	Çmimi njesi/ leke m2	Vlera ne leke	Adresa e pronarëve që preken nga shpronsimet	Kufizimet e pronësisë
1	8/148	truall	58.4	8552	10	148	7745	452308	Kavaje	-

Për vazhdimin e mëtejshëm të procedurave të shpronësimit deri në daljen e VKM-së për shpronësim për interes publik ngarkohen Drejtoria e Kadastrës Urbane dhe Menaxhimit të Aseteve Publike, Drejtoria Juridike, Drejtoria e Burimeve Ekonomike, Drejtoria e Planifikimit Zhvillimit të territorit dhe Menaxhimit të Kontratave

Sekretari i përgjithshëm
Arti Çiçolli

Handwritten notes and signatures at the top left of the document.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETERORE E KADASTRES
DREJTORIA VENDORE KAVAJE

Date 23/10/2023

Në pergjigje te kerkeses me nr.17445, dt. 02/10/2023 , ne emer te Bashkia Kavaje, me objekt informacion zyrtar mbi pasurine me nr.8/148 zk 8552 ,ju sqarojme se:

Gjendja juridike e pasurive te paluajtshme , sipas karteles se pasurive te paluajtshme , per ZK 8552 sipas shkreses tuaj , eshte si me poshte :

Nr.	Nr. pas	vol	fq	Pronesia	Lloji I pasurise	Sip.pas m2	shënime	Seksione D - E
1	8/148	10	128	Hysen Zenel Shehi; Dhurata Qemal Cara; Flutura Qemal Beqiri; Gezim Qemal Shehi; Mentor Fehemi Shehi; Yllka Fehemi Gjeçi (Shehi); Mentor Ilaria Claudio Tadde; Nikolas Gazment Shehi; Yllka Fehmi Gjeçi	Truall	Siperfaqe totale 577m2, nga keto 577m2 truall dhe 194.82m2 ndertese	Pajisur me certifikate pronesie date 19/10/2020	Ne seksionin D shenimi me ref 00011691 date 16/06/2021''Mbi kete pasuri pozicionohet ndertesa dhe parcela ndertimore e objektit me nr.8/148-ND vol 41 -119. Ne seksionin E kufizimi me ref 00006700 date 30.05.2018 ''Mbi kete pasuri ndodhet nje ndertim i paligjshem.

Veliu

Digitally signed by:
Meda Veliu
Date: 2023.10.23
11:58:13 +02'00'

Digitally signed by:
Dorian Murati
Date: 2023.10.23
12:16:58 +02'00'

DREJTOR
DORIAN MURATI



Vulosur elektronikisht nga Drejtoria
Vendore Kavaje
Date:2023/10/23 11:57:40 +02'00'
K52903801C2023102311573316014



02/07/2024

1

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJE



LEJE INFRASTRUKTURE

Nr. 5507, datë 02/07/2024

Në mbështetje të neneve 27, 29 dhe 39 të ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, neneve 11, 14, 15, 16, 22 dhe 23 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit" i ndryshuar, dhe pas shqyrtimit të aplikimit për "Leje infrastrukture për objektin Rikonstruksion i trotuareve Lagja Sheh", dorëzuar elektronikisht më datë 06/06/2024, me numër aplikimi AN060620240008, nr. Prot 5507 datë __02__/_07__/_2024__, Lagja Sheh, Bashkia Kavajë, dhe dokumentacionit shoqërues të kërkesës si vijon:

- Prokure për autorizimin e aplikuesit
- Kopje e dokumentit të pronesisë
- Deklarata e projektuesit të licencuar, për përputhshmërinë e projektit me dokumentet e planifikimit dhe legjislacionin në fuqi, sipas sistemit online
- Projekti dhe relacioni i eficientes energjitike
- Preventivi i punimeve
- Plani i vendosjes së ndërtimit mbi fragmentin e azhornuar të hartës së parcelës/ave lëshuar me lejen e zhvillimit
- Grafiku i punimeve
- Projekti dhe relacioni teknologjik
- Formati i aplikimit, i nënshkruar elektronikisht

si dhe pas marrjes zyrtarisht të mendimeve nga institucionet publike të parashikuara nga ligji, si vijon:

- Drejtoria Vendore ASHK Kavajë

VENDOSA:

1. Lëshimin e kësaj lejeje infrastrukture për zhvilluesin BASHKIA KAVAJE, NUIS/NID K52903801C, të cilit/cilëve i/u lejohet ndërtimi i objektit "Rikonstruksion i trotuareve Lagja Sheh, Bashkia Kavajë sipas kushteve të zhvillimit që vijnë:

Shenim: Para njoftimit të fillimit të punimeve, të bëhet aktmarreveshja për shpronësimet e ish-pronareve, që cenohen nga ndërtimi i trotuarit.

2. Kjo leje është e vlefshme për një periudhë ____ 2 Muaj ____ nga data e fillimit të punimeve, referuar grafikut të punimeve.

3. Afati i fillimit të punimeve është deri në 1 (një) vit nga data e lëshimit të kësaj lejeje. Kjo leje është e pavlefshme nëse zhvilluesi nuk fillon punimet e ndërtimit brenda afatit një vjeçar pas lëshimit të saj, bazuar në nenin 40 të ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar.

4. Nëse ndërtimi ka filluar pas kalimit të afatit njëvjeçar apo vijon edhe pas përfundimit të afatit të përfundimit të punimeve, punimet konsiderohen të paligjshme.

5. Në rast shkelje të kushteve të kësaj leje do të merren masa në përputhje me ligjin, deri në prishje të punimeve të kryera. Zhvilluesi, zbatuesi dhe mbikqyrësi i punimeve janë përgjegjës solidarisht në rast kryerje punimesh në shkelje të kësaj lejeje apo të ligjeve që rregullojnë veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e

Shqipërisë, bazuar në nenin 39 të ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar.

6. Zhvilluesi është i detyruar që të njoftojë nëpërmjet sistemit e-leje, bashkinë për fillimin e punimeve si dhe të komunikojë emrat e zbatuesit, mbikqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve, së bashku me licensat profesionale përkatëse. Në mungesë, punimet konsiderohen të paligjshme.

7. Zhvilluesi është i detyruar që, pas përfundimit të ndërtimit dhe përpara përdorimit të tij, të kërkojë nëpërmjet aplikimit elektronik e-leje nga bashkia që të pajiset me certifikatën e përdorimit të tij.

8. Kundër kësaj lejeje, zhvilluesi mund të paraqesë ankim brenda 15 ditëve nga data e marrjes njoftim

KRYETARI I BASHKISË

Fisnik
Qosja

Digitally signed by Fisnik
Qosja
Date: 2024.07.03 14:57:48
+02'00'



RELACION-TEKNIK

OBJEKTI: RIPARIM I TROTUAREVE LAGJA NR 5

Përmbajtja

Relacion Teknik

TE PERGJITHESHME

Pozicioni gjeografik

Kushtet klimatike te zones

Kushtet ambientale



GJENDJA E INFRASTRUKTURES EKZISTUESE

Zhvillimi urban

REALIZIMI PROJEKTIT

DETYRA MBI REALIZIMIN E PROJEKTIT

Infrastruktura rrugore

TE PERGJITHESHME

POZICIONI GJEORAFIK

Rruga "Indrit Cara" (shetitorja kryesore) shtrihet ne pjesen jugore te qytetit te Kavajes dhe eshte nje nga akset me te rendesishme te gjithë zones dhe pershkron te gjithë zonat e urbanizuara dhe te populluara lagjen nr 4,5 si dhe fshatrat perreth Vorrozen, Shtodher etj... Trotuari i perket ZK8552.

PARAMETRAT SOT:

Rruga sot eshte pershkuar nga dy anet me trotuare vetem nje pjese ku ne do te bejme riparimin nuk ka trotuare duke bere nderprerjen nderprerjen e tij per shkak te nje avllie te vjeter te rrenuar. Pra aktualisht nuk ka trotuare .Ka mbishtresa dheu, avlli te rrenuara



KUSHTET KLIMATIKE TE ZONES

Kushtet klimatike te zones ne studim jane ato te Kavajes qe karakterizohet nga nje klime mesdhetare e kontinentale pergjithesisht e lagesht dhe jo e ftohte ne dimer dhe me vere te nxehte dhe te thate. Temperatura mesatare shumevjecare eshte 10° dhe vlerat minimale dhe maksimale jane perkatesisht -5°dhe+41°.

Intensiteti i rreshjeve me siguri 20 %, 1 here ne 5 vjet, eshte 19.5 mm ose 117mm/ore, per t=24 ore 109 mm.

Ngricat jane kryesisht ne muajt dhjetor-shkurt, qe rralle here mund te kete shtrese akulli qe nuk i kalon 5 cm.

Ererat qe fryjne nuk e kalojne shpejtesine 30 – 50 km/ore, me drejtime te ndryshme por dominues eshte drejtimi veri – perendeim- jug – lindje.

Lageshtira e ajrit eshte e madhe ne dimer dhe vere e nxehte qe karakterizohet nga nje ulje e ndjeshme e lageshtires se ajrit, gje qe ben te nevojshme marrjen e masave per lagijen e rugeve.

KUSHTET AMBIENTALE

Nga pikepamja urbane zona karakterizohet nga dendesi popullesie si rezultat dhe ndertimit e zhvillimit te ndertimi para dhe gjate viteve 90 e ne vazhdim si dhe prurja e madhe nga fshatrat e tjera te Golemit dhe nga zonat e jugut te Shqiperise per shkak dhe te pozicionit gjeografik te kesaj zone (afersia me zonen turistike) . Nje problem i rendesishem per kete zone eshte vazhdimi i ketij trotuari per mos pengimin e kembesoreve te cilet duke dale ne rruge mund te jene te rrezikuar.

Kjo krijon harmonizim te ketyre rrugeve duke shtrire trotuare ne te gjithe gjatesine e tyre.

INFRASTRUKTURA EKZISTUESE:

-Ky projekt eshte i shoqeruar me flete te vecante ku jane pershkruar punimet qe do te kryhen per riparimin e trotuarit se e vetmja zone ka mbetur pa trotuar dhe ky ben lidhjen midis dy trotuareve sepse ktu ishte krijuar nderprerje per shkak te nje avllie te rrenuar. Prandaj para fillimit te punimeve te shikohen me kujdes te gjitha hollesite per te mos demtuar rrjetin e dendur ekzistues inxhinierik, gjithashtu te njoftohen dhe te kontaktohet me pronat e per shpronesim te pronareve pasurise per aq m2 sa eshte sipërfaqja e trotuarit.

PERSHKRIMI I PUNIMEVE QE DO TE KRYHEN:

- Punime germimi dhe nivelimi .
- F.V. bordure te parapergatitura 20x35 dhe kondrabordure e derdhur ne vend 25x12..
- Shtrese zhavorri 10 cm para shtrimit me beton.
- Shtrese betoni. Kjo shtrese behet me trashesi 10cm(sipas detajit te projektit), vendoset dhe zgare me $d=6$ mm.
- Shtese pllaka betoni per trotuarin
- Nenshtrese rere per nivelim pllakash
- Bordura pemesh
- Peme dekorative
- Beton per fiksime bordurash

Hartoi

Drejtoria e Kontrollit, Zhvillimit Urbanistik e Proneve .



Bekim
Shala

Digitally signed by
Bekim Shala
Date: 2024.06.05
09:05:14 +02'00'


PROJEKTI I TROTUARIT LAGJA Nr5

RILEVIMI I TROTUARIT LAGJA Nr5 SH.1:500

ORTOFOTO I TROTUARIT LAGJA Nr5 SH.1:1000

Perspektiva

Rilevimi i Pasurisë 8/148 ne Zonen Kadastrale 8552 me Indeks Harte KJ: -J-5
Bashkia Kavaje, Prona Bashkepronareve Shehallaret i mer trotuari 58.4m²



POROSITESI
BASHKIA KAVAJË

PROJEKTUES
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE
ZHVILLIMIT TERITORIT

TROTUARI I RI PER TU BERE

FAZA - PROJEKT ZBATIMI

SHKALLA 1:500 Data: Mars 2024

VIZATIMI Nr: A.001

PLANVENDOSJA

PROJEKTI I TROTUARIT LAGJA Nr5



TROTUARI I RI PER TU BERE



POROSITESI
BASHKIA KAVAJË

PROJEKTUES
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE
ZHVILLIMIT TERITORIT

TROTUARI I RI PER TU BERE

FAZA - PROJEKT ZBATIMI

SHKALLA 1:8000 Data: Mars 2024


VIZATIMI Nr. A.001

PLANVENDOSJA

PROFIL TIP. I TROTUARIT L.SHARRE Nr5



aksi i trotuarit



Pllaka betoni t= 6cm

Shtrese rere t=4cm

Beton M=200 t= 10cm+zgareØ8

Shtres zhavorri t= 10cm

toke natyrale

Digitally signed by
Bekim Shala

Bekim

ShalaPOROSITESI

BASHKIA KAVAJË

PROJEKTUES

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE
ZHVILLIMIT TERITORIT

TROTUARI I RI PER TU BERE

FAZA - PROJEKT ZBATIMI

SHKALLA 1:1000 Data: Mars 2024

VIZATIMI Nr: A.001

PLANVENDOSJA

**VENDIM****Nr. 89, datë 3.2.2016****PËR MIRATIMIN E HARTËS SË
VLERËS SË TOKËS NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", të ndryshuar, dhe në vijim të pikës 3, të vendimit nr. 658, datë 26.9.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e metodologjisë për vlerësimin e pronave të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë, sipas hartave që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Vendimi nr. 514, datë 30.7.2014, i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e vlerës së pronës për secilin qark të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, shfuqizohet.

3. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Ministria e Zhvillimit Urban, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



